



Pranuar / Dorezuar Prilimeno/Prodato Received/Delivered	07-04-2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHKK	1662/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.191/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2956/19 të datës 01.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.592/2019 të datës 30.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Vehbi Ibrahim", Nr.18, lagjja Zabel në Gjilan, kundër Vendimit me numër Ref.SBNJD-291/19 të datës 04.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike "*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin I nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin I nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.04.2021, mori këtë

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.592/2019 e datës 30.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Ref.SBNJD-291/19 i datës 04.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 28.06.2019 Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan ankuesit i ka kërkuar deklaratë me shkrim që deri më datë 01.07.2019 të njoftoj se ku ishte në këtë kohë dhe me lejen e kujt keni munguar. Ankuesi më datë 01.07.2019 ankuesi ka dhënë deklaratën e tij në bazë të të cilës ka kundërshtuar pretendimet për mungesë në punë, ndërsa më datë 04.07.2019 Menaxherja e Personelit ka përgatitur raport pune nga vizita monitoruese e datës 03.07.2019 në Drejtorinë Koordinuese në Gjilan të Agjencisë Pyjore të Kosovës në bazë të të cilit është konstatuar se gjatë vizitës ankuesit nuk ka qenë në zyre. Në bazë të lartcekurave ndaj ankuesit punësuar sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2012 në pozitën "Zyrtar për Çështje Ekonomike" në Drejtorinë Koordinuese në Gjilan të Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 05.07.2019 Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje me shkrim" për shkak që nuk është gjendur në vendin e punës më datë 28.06.2019 dhe 03.07.2019.

Ankuesi kundër vërejtjes me shkrim, më datë 05.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 04.09.2019 nxjerr Vendim me numër Ref. SBNJD-291/19 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër Ref. SBNJD-291/19 të datës 04.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.09.2019 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmshek@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar më datë 30.09.2019 me numër protokoll 4598/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës më datë 07.10.2019 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia Pyjore e Kosovës. Këshilli më datë 15.10.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Pyjore e Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 12.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2956/19 të datës 01.03.2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 30.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.09.2019 me numër protokoll 4598/2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref.SBNJD-291/19 i datës 04.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës; Vërejtje me shkrim e datës 05.07.2019; Kërkesën për deklaratë e datës 28.06.2019; Kërkesë për anulim-shfuqizim të kërkesës për deklaratë e datës 05.07.2019 e parashtruar nga ankuesi; Deklaratë mbi shkeljen e evidentimit në formularin e ardhje-shkuarjes në punë; Deklaratë lidhur me parregullsitë e hasura në formularin e ardhje-shkuarjes në punë datë 31.12.2010; Kërkesë për aprovimin e trajnimit nga ankuesi e datës 15.10.2018; E-mailin e datës 23.10.2018, 15.10.2018 nga ankuesin; Përgjigje në kërkesë e datës 27.10.2016; Vendimin e datës 21.11.2016; Përgjigje në njoftimin e datës 27.09.2016; E-mailin e datës 04.09.2019 nga ankuesin për Deklaratë në bazë të kërkesës e datës 01.07.2019; Ankesa e plotësuar e datës 07.06.2019 dhe 13.06.2019; Kërkesë për përmirësim të kushteve dhe ambientit të punës e datës 01.05.2019; Ankesë e datës 05.06.2019; E-mailin e datës 03.05.2019 dhe 27.12.2018 nga ankuesi për E-mailin e datës 13.12.2018 nga ankuesi për Njoftimi datës 25.08.2017; Ekstrakt nga

procesverbali i takimit të mbajtur më datë 13.03.2018 i datës 20.03.2018; Kërkesa e datës 24.03.2011; Kërkesë për një takim pune më drejtorin e datës 04.07.2011; Njoftim lidhur me zhurmën e datës 15.10.2010; Kërkesën e datës 17.07.2019; E-mailin e datës 27.09.2019 nga ankuesi për ankesa.kpmsk@rks-gov.net; Akt Emërimit e datës 31.01.2012 të ankuesit; Shkresë për Servisin e Kompjuterit Zyrtar e datës 03.07.2019; Raport pune nga vizita monitoruese e datës 03.07.2019 në DKR të APK-së në Gjilan i datës 04.07.2019; Procesverbal i datës 13.08.2019; Ankesën e datës 05.08.2019 e parashtruar nga ankuesi; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2018 dhe 2017 për ankuesin dhe Përgjigjen e datës 15.10.2019 në ankesë të dërguar nga Agjencia Pyjore e Kosovës; Njoftimin e datës 12.11.2019 për ankuesin; E-mailin e datës 18.1.2019 nga ankuesi; Aktgjykimin A.nr.2956/19 të datës 01.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Plotësimin e ankesës datë 30.03.2021 me Nr. Pro:1481/2021 dhe Nr. Prot:1482/2021 me provat Vendimin e datës 18.03.2021; Formulari i evidencës së ardhjes në punës datë 02.05.2019, 15.05.2011, 08.06.2018, 30.05.2018, 11.08.2011, 04.05.2018, 08.05.2018, 19.07.2017, 19.09.2018, 26.04.2018; Foto të ndryshme; Ankesën e datës 01.11.2019; E-mailin e datës 13.02.2020, 03.11.2019; Njoftim i datës 25.12.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës dhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që masa disiplinore e shqiptuar është tendencioze dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që vetëm ndaj meje janë marrë masat disiplinore; Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me refuzimin e ankesës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që masa disiplinore e shqiptuar është tendencioze dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që vetëm ndaj meje janë marrë masat disiplinore, ka konstatuar që në bazë të deklaratës së datës 01.07.2019 të ankuesit njëjti nuk ka mund të mohoj që nuk ka qenë në vendin e punës më datë 28.06.2019, ndërsa në bazë të raportit të punës nga vizita monitoruese të datës 03.07.2019 në Drejtorinë Koordinuese në Gjilan të Agjencisë Pyjore të Kosovës të hartuar më datë 04.07.2019 nga Menaxherja e Personelit, konstatohet se gjatë monitorimit ankuesi ka munguar në punë, ndërsa pas 15 minuta nga momenti i monitorimit ankuesi është paraqitur në punë dhe është njoftuar për vizitën, në të njëjtën kohë është pyetur për mungesë në punë, kurse ankuesi ishte përgjigjur *“se ishte me punë në Komunë”*, ndërsa është pyetur se a ka qenë zyrtarisht apo privatisht dhe ishte përgjigjur *“se kishte punë”* po ashtu ishte pyetur se a kishte marr leje për dalje nga puna ndërsa ishte përgjigjur *“se nuk kishte marr leje nga askush”*.

Meqenëse ankuesi në bazë të provave të lëndës me asnjë provë nuk ka mund të argumentoj pretendimin e tij ankimor dhe nuk ka asnjë dëshmi që për kohën e mungesës në punë të ketë njoftuar udhëheqësin e tij të drejtpërdrejt, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që nëpunësit civilë në këtë rast ankuesi janë të detyruar të jenë prezent në vendet e tyre të punës, ndërsa për çdo mungesë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre, siç përcaktohet me nenin 59 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëpunësit civilë janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civilë janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara”* dhe *“Nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin”* dhe nenin 7 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 05/2010 e

Orarit të Punës, i cili përcakton se: *“Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, nëpunësi civil duhet marr leje nga menaxheri drejtues”.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesi me këto veprime ka bërë shkelje të lehtë të detyrave të punës për të cilat edhe i është nënshtruar masave disiplinore siç parashihet me dispozitat nenit 63 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëpunësit civilë do t’u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj”*, andaj ankuesi me veprimet e tij është përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji siç përcaktohet me nenin 64 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në ato që u thanë më lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se masa disiplinore e shqiptuar *“vërejtje më shkrim”* e datës 05.07.2019 e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjiilan ndaj ankuesit është në pajtim me nenin 64, 65 dhe 66 paragrafin 3 nën paragrafin 3.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 7 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me refuzimin e ankesës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Ref. SBNJD-291/19 të datës 04.09.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.2956/19 të datës 01.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.191/2021, datë 07/04/2021

Avdyli BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.